

# *Llojet e burgjeve dhe kampeve të punës dhe pozita e personave të dënuar në Shqipëri gjatë periudhës së diktaturës komuniste*

*Rexhep Gashi\**

## *Përmbledhje*

Në këtë artikull paraqiten dhe analizohen llojet e burgjeve dhe kampeve të punës, struktura dhe organizimi i tyre si dhe pozita e personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit me burgim në Shqipëri gjatë kohës së diktaturës komuniste. Gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore e deri me fitoren e demokracisë në Shqipëri (1944-1991) kanë funksionuar një numër i madh i burgjeve dhe kampeve të punës, në të cilat e kanë mbajtur dënimin me burgim një numër i madh i personave të dënuar, pjesa dërmuese e të cilëve ishin të dënuar politikë. Numri i madh i të burgosurve gjatë kësaj periudhe kohore si dhe i burgjeve dhe kampeve të punës ishte para se gjithash si pasojë e politikës ndëshkimore mjaft të ashpër që udhëhoqi shteti komunist shqiptar, të cilën politikë e kishte orientuar veçmas kundër kundërshtarëve të regjimit komunist. Në këtë drejtim, një vend i merituar do t'u kushtohet edhe organizimit të burgjeve dhe kampeve të punës, qëllimit të dënimit me burgim si dhe të pozitës së personave të dënuar gjatë mbajtjes së këtij dënimi. Qëllim i këtij artikulli është veçmas të hedhë dritë lidhur me llojet dhe qëllimin e themelimit të burgjeve dhe kampeve të punës, pozitën e rëndë të personave të dënuar, kufizimin e të drejtave të tyre dhe trajtimin johuman të tyre gjatë periudhës së shtetit monist në Shqipëri.

**Fjalë kyç:** Shqipëria, burgjet, diktatura komuniste, kampet e punës, tortura, të burgosur politikë.

---

\* *Profesor i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe i Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB-Rinvest, [rexhep\\_gashi@hotmail.com](mailto:rexhep_gashi@hotmail.com)*

## Hyrje

Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri ka rrugën e vet të zhvillimit dhe transformimit. Mjetet dhe metodat e ekzekutimit të këtij dënimi dhe mënyra e trajtimit të personave të dënuar gjatë qëndrimit në institucione korrektuese, që nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptar e deri në ditët e sotme, ishin në varësi nga rrethanat e caktuara historike, shoqërore, ekonomike, politike, ideore, kulturore etj., si dhe nga vetë qëllimi i këtij dënimi. Me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar lind edhe e drejta shqiptare në përgjithësi si dhe e drejta penale në veçanti, si dhe nxirren edhe dispozitat juridike penitensiare dhe krijohen kushtet për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe trajtimin e personave të dënuar.

Deri me shpalljen e shtetit të pavarur shqiptar (28 nëntor 1912), fusha e sistemit ndëshkimesor dhe në përgjithësi reagimi shoqëror ndaj sjelljeve të rrezikshme shoqërore nuk është ndriçuar sa duhet në trojet etnike shqiptare. Për këtë periudhë të gjatë kohore, e veçmas për kohërat e lashta, janë të varfra burimet historiko-juridike dhe të dhënat e tjera që u referohen sistemit të dënimeve dhe mënyrës së ekzekutimit të tyre ndaj kryesve të veprave penale. Shqiptarët, të cilët janë pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve, një kohë të gjatë ishin nën sundimin e popujve të tjerë. Këto troje etnike ilire e më pas shqiptare janë sunduar nga romakët, e më pas nga bizantinët dhe së fundi duke filluar nga fundi i shekullit XIV dhe fillimi i shek.XV ato pushtohen edhe nga Perandoria Osmane, i cili pushtim zgjati për gati pesë shekuj. Kjo pati për pasojë edhe zbatimin e së drejtës së huaj edhe në fushën e sistemit të dënimeve dhe të ekzekutimit të tyre.<sup>1</sup> Ndërkaq, në

---

<sup>1</sup> Deri me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, në viset e pushtuara shqiptare zbatoheshin e drejta e sheriatit, e cila bazohej në Kuran, si dhe ishin në zbatim disa Kanunat dhe Kodi Penal Otoman i vitit 1878, i cili veçoi në Shqipëri edhe pas shpalljes së pavarësisë deri në vitin 1928. Në këtë kod kanë qenë të parapara këto dënime për krime: dënimi me vdekje, pranga të përjetshme a të përkohshme me ekspozim, mbyllja në kështjellë, burgim i përjetshëm, burgim i përkohshëm, shterim (humbja) i përjetshëm titulli e nëpunësisë, rrëzim i të drejtave politike, dëbim prej nëpunësisë dhe gjoba. (Shih: Ligja penale otomane, Tiranë, 1924, fq.1).

disa krahina shqiptare të cilat ishin kryesisht malore, dhe të cilat nuk iu nënshtruan administratës së huaj, është zbatuar e drejta zakonore shqiptare edhe në fushën e sistemit ndëshkimor dhe ekzekutimit të dënimeve.<sup>2</sup>

Me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë nga Kuvendi Kombëtar që u mbledh në Vlorë më 28 Nëntor 1912 formohet qeveria e parë shqiptare, kryetar i së cilës u zgjodh Ismail Qemali. Por, më 1913, Konferenca e ambasadorëve në Londër ndonëse e pranoi krijimin e shtetit shqiptar, la jashtë tij, në mënyrë krejt arbitrare, Kosovën dhe vise të tjera të banuara shqiptare, të cilat bënë gjysmën e territorit të vendit dhe gjysmën e popullsisë shqiptare. Gjatë periudhës prej shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë e deri me fillimin e Luftës së Dytë Botërore janë ndërruar disa qeveri shqiptare. Po ashtu që nga 1 shtatori 1928 Shqipëria ishte monarki me mbret Ahmet Zogun, e cila mbretëri zgjati deri me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste më 7 prill 1939. Që nga shpallja e pavarësisë së Shqipërisë e deri me mbarimin e Luftës së dytë botërore, përkatësisht me çlirimin e Shqipërisë më 29 nëntor 1944, në këtë vend ishin në zbatim disa ligje dhe akte të tjera juridike që kanë përmbajtur dispozita mbi ekzekutimin e dënimit me burgim, organizimin e burgjeve dhe trajtimin e pozitës së personave të dënuar.

Periudha pas çlirimit e deri me fitoren e demokracisë në Shqipëri (1944-1991), pra deri me rënien e sistemit monist, u karakterizua nga organizimi gradual i një shteti tipik të diktaturës komuniste, që për më tepër se 40 vjet është drejtuar nga Partia-shtet dhe udhëheqësi i saj Enver Hoxha. Gjatë kësaj periudhe kohore janë nxjerrë disa akte juridike penitensiare të cilat ishin mjete të fuqishme në realizimin e mësimëve të Partisë-shtet, e që pati për pasojë kufizimin e shumë të drejtave të personave të dënuar dhe keqësimin e dukshëm të pozitës së tyre gjatë mbajtjes së dënimit me burgim. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kohore kanë funksionuar shumë burgje dhe kampe të punës,

---

<sup>2</sup> Si burime kryesore të së drejtës zakonore shqiptare janë: Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Labërisë, Kanuni i Pukës, Kanuni i Lumës dhe Kanuni i Maleve. Në këto kanune gjenden një varg normash të karakterit penal që u referohen dënimeve dhe mënyrës së ekzekutimit të tyre.

të cilat shërbenin për mbajtjen e dënimit me burgim, e në të cilat kushtet e jetës dhe të punës së të dënuarve ishin mjaft të rënda, të shoqëruara edhe me përdorimin e dhunës fizike dhe të torturës.

Në këtë artikull paraqiten dhe analizohen llojet e burgjeve dhe kampeve të punës që kanë funksionuar gjatë periudhës së diktaturës komuniste në Shqipëri. Po ashtu, do të trajtohet edhe pozita e personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit me burgim gjatë tërë kohës së ekzistimit të shtetit monist e deri me fitoren e demokracisë në Shqipëri (1944-1991). Gjatë trajtimit të këtij zhvillimi historik do t'i kemi për bazë burimet arkivore, dispozitat ligjore, literaturën përkatëse juridiko-penale dhe penologjike, praktikën penitensiare, ditarët e burgut dhe publikimet e ndryshme të personave të dënuar, intervistat me ish të dënuar dhe të dhënat e tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me ekzekutimin e dënimit me burgim dhe trajtimin e personave të dënuar gjatë kësaj kohe. Në këtë mënyrë do të njihemi me karakteristikat themelore të ekzekutimit të dënimit me burgim në Shqipëri gjatë periudhës së gjatë të shtetit totalitar si dhe do të paraqiten edhe karakteristikat themelore të burgjeve dhe të kampeve të punës si dhe të pozitës së personave të dënuar gjatë mbajtjes së këtij dënimi.

### ***1. Llojet e burgjeve dhe të kampeve të punës në Shqipëri gjatë periudhës së diktaturës komuniste***

Gjatë periudhës së shtetit totalitar e deri me fitoren e demokracisë në Shqipëri dënimi me burgim është mbajtur në burgjet dhe kampet e punës korrektuese ose “repartet e riedukimit”, të cilat ishin në numër mjaft të madh dhe ishin në vartësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore janë ndërtuar disa dhjetëra burgje dhe kampe të punës për mbajtjen e dënimit të personave të dënuar. Numri i të burgosurve të cilët mbajtën dënimin në këto burgje dhe kampe të punës ishte mjaft i madh, e veçmas ishte i madh numri i të burgosurve politikë në vitet e para pas vendosjes së pushtetit komunist. Kësisoj, sipas gjendjes së muajit janar të vitit 1947, prej gjithsej 4749 të burgosur, 3659 ishin të burgosur politikë dhe 1090

të burgosur ordinere.<sup>3</sup> Pra, kemi të bëjmë me një raport përafërsisht 1:3 në favor të të burgosurve politikë. Numri i të burgosurve shumë shpejt do të rritet edhe më tej, kështu që në vitin 1950 ky numër arrin në 7168 të burgosur dhe 2000 të internuar, respektivisht në 9168 veta.<sup>4</sup> Në burgjet dhe kampet e punës të sistemit komunist, siç pohojnë shumë ish të dënuar politikë, kushtet e qëndrimit të të dënuarve ishin johumane dhe në to bëhej një trajtim çnjerëzor i të dënuarve, gjë që në masë të caktuar ato shërbenin edhe për eliminimin fizik të kundërshtarëve politikë të regjimit.

Shtimi mjaft i madh i numrit të të burgosurve dhe i burgjeve në periudhën e pasqirimit në Shqipëri ishte rezultat i politikës ndëshkimore mjaft të ashpër që udhëhoqi shteti komunist, të cilën politikë e kishte orientuar veçmas ndaj kundërshtarëve të regjimit. Gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore ngrihen edhe shumë kampe të punës në të cilat bëhej shfrytëzimi i punës së të dënuarve në ndërtimet e shumta në tërë vendin. Numri i këtyre burgjeve dhe kampeve të punës gjatë periudhës së sistemit komunist ndryshon në etapat e caktuara të zhvillimit të shtetit shqiptar dhe nuk është lehtë të konstatohet numri i saktë i tyre. Po ashtu, nuk është lehtë të konstatohet edhe numri i saktë i personave të dënuar të cilët mbajtën dënimin gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore. Sipas evidencës së vitit 1947 të Drejtorisë së Kampeve dhe të Burgjeve, gjatë këtij viti në Shqipëri kishte 18 burgje (prej të cilave 8 ishin burgje politike, 7 burgje ordinere dhe 3 burgje të përziera).<sup>5</sup> Gjatë kësaj kohe ishin duke funksionuar edhe kampet e para të punës së të dënuarve si: Kampi i Maliqit, i Bedenit, i Vllashkut, i Valiasit etj. Duhet theksuar se numri i kampeve të punës vazhdimisht ka shënuar rritje, veçmas pas vitit 1950. Me një vendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme nr.1620 të vitit 1955, kampet u quajtën reparte dhe u emërtuan si vijon: Kampi nr.1-Reperti nr.301; Kampi nr.2-Reperti nr.303; Kampi nr.3-Reperti nr.305; Kampi nr.4-Reperti nr.307; Kampi nr.5-Reperti nr.309, ndërsa burgjet u emëruan:

---

<sup>3</sup> Sipas F.Sufaj, Historia e burgjeve të Shqipërisë gjatë shekullit XX, "Albin", Tiranë, 2000, fq.106. Po ashtu gjatë këtij viti Shqipëria kishte edhe 1272 të internuar politikë.

<sup>4</sup> Ibid., fq.110.

<sup>5</sup> Sipas F.Sufaj, op.cit., fq.116.

Burgu Shkodër-Reperti nr.315; Burgu Vlorë-Reperti nr.319; Burgu Korçë-Reperti nr.317; Burgu Tiranë-Reperti nr.313; dhe Burgu Burrel-Reperti nr.321.<sup>6</sup> Ndërkaq, sipas gjendjes nëntor-dhjetor të vitit 1962 në Shqipëri ishin këto burgje dhe reparte: Reparti 301 Bulqizë, Reparti 307 Tiranë, Reparti 321 Burrel, Reparti 309 Tiranë, Reparti 303 Tiranë, Reparti 315 Shkodër, Reparti 318 Korçë, Reparti 319 Vlorë, Reparti 305 Tiranë, Reparti 313 Tiranë, Reparti i Artizanatit dhe Kampi Durrës.<sup>7</sup> Kurse numri i tërësishëm i të burgosurve ishte 4662 persona, prej të cilëve 1809 ishin të burgosur politikë dhe 2853 ordinerë.<sup>8</sup>

Gjatë periudhës së sundimit komunist në Shqipëri numri i burgjeve dhe i kampeve të punës ishte mjaft i madh. Duke u mbështetur në literaturën mbi burgjet dhe kampet e punës të Shqipërisë komuniste si dhe në të dhënat arkivore dhe dëshmitë e personave të dënuar të kësaj periudhe kohore, mund të konstatohet se si burgje dhe kampe të punës më të njohura gjatë kohës së sistemit totalitar në Shqipëri ishin: 1. Burgjet e mbyllura: *Burgu i Gjirokastrës, Burgu i Tepelenës, Burgu i Vlorës, Burgu i Beratit, Burgu i Korçës, Burgu i Elbasanit, Burgu i Durrësit, Burgu i vjetër i Tiranës, Burgu i Ri i Tiranës, Burgu i Burrelit, Burgjet e Shkodrës, Burgu i Peshkopisë, Burgu i Artizanatit*; 2. Kampet me punë të detyruar të bonifikimeve: *Kampet e Maliqit, Kampi i Llakatundit, Kampi i Levanit, Kampi i Varibobës, Kampi i Radostinës, Kampi i Vlashkut, Kampi i Tërbufit, Kampi i Gosës, Kampi i Lekajit, Kampi i Bedenit, Kampi i Jubës, Kampi i Thumanës, Kampi i Gjadrit ose i Zadrimes, Kampi i Skrofotinës*; 3. Kampet me punë të detyruar në bujqësi dhe për hapjen e tarracave: *Kampi i Torovicës, Kampi i Zejmenit, Kampi i Valiasit, Kampi i Belshit, Kampi i Borshit, Kampi i Shënvoasisë ose i "Përparimit"*; 4. Kampet me punë të detyruar të ndërtimit: *Kampi i stadiumit "Qemal Stafa", Kampi nr.4 i Tiranës, Kampi i stadiumit "Dinamo", Kampi i Sanatoriumit, Kampi i bllokut "Puna", Kampi i kompleksit sportiv "Dinamo", Kampi i urës së Bonës, Kampi i Bishqemit*; 5. Kampet me punë të detyruar për ndërtimin e veprave industriale: *Kampi i Kombinatit Ushqimor Tiranë, Kampi i Kombinatit të mishit dhe të qumështit Tiranë, Kampi i Rubikut, Kampi i Laçit, Kampi i Fushë Krujës,*

---

<sup>6</sup> Sipas F.Sufaj, *Ibid.*, fq.116-117.

<sup>7</sup> *Ibid.*, fq.127.

<sup>8</sup> *Ibid.*

*Llojet e burgjeve dhe kampeve të punës dhe pozita e personave të dënuar në Shqipëri gjatë periudhës së diktaturës komuniste*

*Kampi i fabrikës së çimentos Elbasan, Kampi i Rrepsit Mirditë, Kampi i Balshit; 6. Kampet me punë të detyruar për ndërtimin e aeroporteve: Kampi i urës Vajgurore, Kampi i Rinasit; 7. Kampet me punë të detyruar në miniera: Kampi i Bulqizës, Kampi i Spaçit, Kampi i Qafëbarit; 8. Burgjet dhe kampet me punë të detyruar të grave të dënuara për motive politike: Aneksi i grave në Burgun e vjetër të Tiranës, Kampi i grave në Valias, Burgu i Artizanatit për gratë, Kampi i Kuçovës, Kampi i Kosovës së Lushnjës, Kampi i Sharrës etj.<sup>9</sup> Pra, siç mund të vërehet, numri i kampeve të punës gjatë kësaj periudhe ishte dukshëm më i madh në krahasim me burgjet. Në këto kampe të punës janë kryer shumë punë të cilat ishin të lidhura me të gjitha ndërtimet e vendit si: nxjerrja e mineraleve, tharja e kënetave, rrjeti i vështirë i kanaleve vaditëse, ndërtimi i uzinave dhe i fabrikave, ndërtimi i aeroporteve, ndërtimi i stadiumeve, i blloqeve të ndërtesave, i komplekseve sportive etj.*

Burgjet e kësaj periudhe kohore dalloheshin nga kampet e punës. Zakonisht në burgje mund të dërgoheshin për të mbajtur dënimin personat e dënuar, të cilët, për shkak të gjendjes së tyre fizike, nuk kanë pasur mundësi të kryenin ndonjë punë në kampet e punës (repartet e riedukimit), si dhe ata të cilët gjatë kohës së mbajtjes së dënimit në kampet e punës (repartet e riedukimit) kanë shkelur rëndë dhe në mënyrë sistematike rregullat e brendshme ose në ndonjë mënyrë tjetër mbajtja e tyre në kampet e punës ose repartet e riedukimit ka paraqitur rrezikshmëri. Po ashtu burgjet dalloheshin nga kampet e punës edhe për nga regjimi i mbajtjes së dënimit. Në burgje regjimi i mbajtjes së dënimit ishte më i rëndë në krahasim me kampet e punës ose repartet e riedukimit nëpërmjet punës. Të dënuarit gjatë mbajtjes së dënimit në burgje kishin të drejta më të kufizuara sesa në kampet e punës. Po ashtu në burgje nuk organizohej puna e të dënuarve. Edhe masat disiplinore ndaj të dënuarve ishin më të rënda sesa në kampet e punës ose repartet e riedukimit nëpërmjet punës.

---

<sup>9</sup> Gjerësisht shih: Agim Musta, *Burgjet e shtetit burg (Prisons of the Prison State)*, "Toena", Tiranë, 2000, fq.8-64; Haxhi Sula-Pullumb Kaso, *Diktatura...*, Tiranë, 1995, fq.11-12; Josif Zegalli, *Rrëfime nga burgju i diktaturës komuniste*, Tiranë, 1999, fq.12-28 etj.

Gjatë periudhës së sundimit komunist, edhe numri i personave të dënuar të cilët kanë mbajtur dënimin me burgim ishte mjaft i madh. Ky numër ka ndryshuar në periudhat e caktuara të zhvillimit të shtetit shqiptar. Meqë mungojnë të dhënat e plota mbi numrin e saktë të personave të dënuar me dënim me burgim gjatë tërë kësaj periudhe të gjatë kohore, në shkrimet e ndryshme të autorëve të cilët ishin ish të dënuar në këto burgje dhe kampe të punës si dhe në shtypin e përditshëm dhe periodik hasim në shifra jo të plota të numrit të personave të dënuar me këtë lloj dënimi. Kështu, sipas autorit A. Musta, ish i dënuar politik, në Shqipëri gjatë periudhës 1945-1991 kanë mbajtur dënimin në burgje dhe në kampet e punës rreth 20.000 persona fizikë, duke përfshirë nga ky numër rreth 2500 të pushkatuar.<sup>10</sup> Ndërsa sipas autorit J.Zegalli, po ashtu ish i dënuar politik, gjatë kohës së shtetit totalitar të burgosur politikë ishin rreth 14555 meshkuj dhe 450 femra.<sup>11</sup> Gjatë mbajtjes së dënimit në këto burgje dhe kampe të punës gjetën vdekjen një numër mjaft i madh i personave të dënuar. Kësisoj vlerësohet se për shkak të kushteve tejet të rënda të mbajtjes së dënimit dhe trajtimit johuman ndaj tyre, në burgjet dhe kampet e punës kanë vdekur rreth 2000 persona.<sup>12</sup>

Në vazhdim do të njihemi me disa burgje dhe kampe të punës më të njohura të kësaj periudhe kohore, ku do t'i bëhet një vështrim i shkurtër historikut të tyre, karakterit dhe organizimit të tyre si dhe pozitës së personave të dënuar gjatë qëndrimit në to. Në trajtimin e këtyre çështjeve për bazë do ta kemi literaturën mbi burgjet dhe

---

<sup>10</sup> A.Musta, *Mandelët e Shqipërisë*, Tiranë, 1993, fq.8. I afërt me të këtë numër është edhe publikimi i numrit të personave të burgosur nga ana e Gazetës së Qendrës Shqiptare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, nr.1, të vitit 1996, sipas së cilës gjatë kësaj periudhe kohore janë burgosur 17900 persona, prej të cilëve 952 kanë vdekur në burgje. Ndërkaq, disa autorë përmendin shifra mjaft të larta të personave të dënuar. Kështu, në librin "Diktatura...", Shtëpia botuese "Alta", Tiranë, 1995, fq.3, autorët Haxhi Suli-Pullumb Kaso, po ashtu ish të dënuar politikë, duke u bazuar në të dhënat jo të plota të arshivës së Ministrisë së Brendshme, theksojnë se gjatë kësaj periudhe kohore janë dënuar rreth 600.000 persona.

<sup>11</sup> J.Zegalli, *Rrëfime nga burgu i diktaturës komuniste*, fq.10.

<sup>12</sup> A.Musta, *Ibid.*, fq.8.



kampet e punës, të dhënat arkivore si dhe ditarët dhe dëshmitë e ish-personave të dënuar.

**Burgu i Gjirokastrës.** Ky burg është ndërtuar në fillim të viteve tridhjetë të shek.XX, në mesin e kalasë së qytetit të Gjirokastrës. Gjatë kohë së sundimit të A.Zogut, burgu i Gjirokastrës ishte si “Burg i Përgjithshëm i Mbretërisë Shqiptare”, ndërsa në kohën e sundimit të diktaturës komuniste, e veçmas gjatë viteve 1945-1950, ky ishte burgu më i madh në vend dhe në te dërgoheshin të dënuarit nga të gjitha viset e vendit.<sup>13</sup> Në këtë burg e kanë mbajtur dënimin të dënuarit meshkuj dhe femra. Ky burg kishte një pamje mjaft të frikshme dhe në qendër të tij gjendej salla e madhe me 7 dritare. Nga kjo sallë degëzoheshin dy degë, ku dega e djathtë, e cila ishte më e vogël, në të vërtetë ishte burgu i grave. Në këtë burg kishte disa dhoma të izolimit ose qeli, në të cilat kushtet e qëndrimit të personave të dënuar ishin mjaft të rënda. Gjatë kohës së sundimit komunist u shtua numri i qelive edhe në katet përdhese të burgut. Në vitet e para të shtetit totalitar kishte rreth 100 të burgosur politikë, të cilët deri në vitin 1949 jetonin vetëm me 400 gr. bukë misri.<sup>14</sup> Për shkak të kushteve të rënda të qëndrimit të personave të dënuar dhe trajtimit johuman të tyre, në këtë burg gjetën vdekjen rreth 100 të dënuar.<sup>15</sup> Ky burg ka funksionuar deri në kohën kur hapen kampet e punës, të cilat bëhen vende të rregullta të mbajtjes së dënimin nga ana e personave të dënuar.

**Burgu i vjetër i Tiranës.** Edhe ky burg konsiderohet si një ndër burgjet e vjetra të Shqipërisë, i cili është ndërtuar në vitin 1930. Ky burg përbëhet prej dy kateve, ku në katin përdhës zakonisht e mbanin dënimin të dënuarit politikë dhe ishin të vendosura edhe qelitë e izolimit. Ndërsa në katin e dytë ishin të vendosur të dënuarit ordinerë dhe një kaush<sup>16</sup> ishte me të dënuar politikë me shtetësi të huaj. Në pjesën perëndimore të këtij burgu gjendej edhe një ndërtesë e vogël

---

<sup>13</sup> A.Musta, *Mandelët e Shqipërisë*, fq.9.

<sup>14</sup> Ibid.

<sup>15</sup> Ibid.

<sup>16</sup> Fjala “kaush” është me origjinë turke dhe ka të bëjë me kthinë të mbyllur me një dritare të vogël, që nuk ajroset mirë, ku mbaheshin disa veta të arrestuar apo të dënuar. Në burgjet e sistemit komunist ky term shënonte dhomën e burgut, ku ishin të vendosur personat e dënuar.

dykatëshe, e cila gjatë kohës së regjimit të Mbretërisë Shqiptare shërbente si burg i grave, ndërsa gjatë kohës së diktaturës komuniste kjo ndërtesë përdorej me të madhe për zbatimin e hetimeve dhe për tortura. Sipas disa ish të dënuarve politikë, gjatë kohës së regjimit komunist e deri në vitin 1957 në këtë burg janë zhvilluar gjyqe speciale të fshehta të sigurimit.<sup>17</sup> Në vitin 1946, mbrapa këtij burgu janë ndërtuar 40 qeli, të cilat ishin pa ajrosje të mjaftueshme dhe mjaft të errëta. Këtu vlen të përmendet qelia nr.18, e cila quhej edhe qelia e vdekjes, pasi ishte pa ajër dhe në errësirë të plotë.<sup>18</sup> Ky burg ishte tepër i ngarkuar me të burgosur në krahasim me kapacitetin e tij. Po ashtu edhe pozita e personave të dënuar ishte mjaft e rëndë. Kësisoj, në Raportin e Analizës vjetore të vitit 1950, ndër të tjera, thuhet: “Në masat disiplinore që merreshin ndaj të burgosurve jo vetëm që i izolonin në biruca, por i lidhnin duar dhe këmbë duke ju hedhur pranga prej shumë kilogramësh”.<sup>19</sup> Veçmas në këtë drejtim ishte e rëndë pozita e të burgosurve politikë, të cilët, siç dihet, trajtoheshin si “armiqtë e popullit”.<sup>20</sup> Më 1967, Burgu i vjetër i Tiranës mbyllet dhe të gjithë të burgosurit politikë kaluan në Burgun e Burrelit. Pas ngjarjeve të marsit të vitit 1997, si pasojë e shkatërrimit që pësuan burgjet dhe të mungesës së kapaciteteve të nevojshme të tyre, ky burg rifillon punën si Burgu 302 i Tiranës dhe aktualisht është rinovuar dukshëm.

**Burgu i ri i Tiranës.** Burgu i ri i Tiranës ose, siç quhej, Reparti 313, është krijuar në vitin 1943. Kjo mund të dëshmohet nga të dhënat e Arkivit Qendror të Shtetit, ku, ndër të tjera, thuhet: “Drejtoria Qendrore Penitenciare më 25.02.1943 njoftonte Kryesinë e Këshillit të Ministrave se për burg politik është marrë një kazermë e Milicisë Fashiste, për të cilën Ministria e Punëve Botore shpenzoi 112000 franga shqiptare, për ta transformuar në burg. Megjithatë ndërtesa nuk është krejt e përshtatshme për këtë qëllim dhe lipset me bë

---

<sup>17</sup> A.Musta, *Ibid.*, fq.10.

<sup>18</sup> *Ibid.*

<sup>19</sup> Në bazë të të dhënave të Arkivit të Punëve të Brendshme (material i cili gjendet në Burgun 302 të Tiranës).

<sup>20</sup> Në vendimin e Qeverisë, datë 1.03.1950, ndër të tjera, thuhet: “Të sqarohen të burgosurit për rëndësinë politike të problemit se pushteti popullor mendon për ta me gjithë veprimtarinë armiqësore të tyre”. (*Ibid.*).

*Llojet e burgjeve dhe kampeve të punës dhe pozita e personave të dënuar në Shqipëri gjatë periudhës së diktaturës komuniste*

ndryshime”.<sup>21</sup> Hapja e këtij burgu u diktua nga rritja e numrit të të burgosurve dhe të arrestuarve për shkak të zgjerimit të Luftës Çlirimtare dhe në vitet 1943-1944 ky burg shërbeu për izolimin e tyre. Në vitet e para të regjimit komunist ky burg është përdorur siç thuhej “për izolimin nga shoqëria të elementit armik dhe kriminelët e luftës”. Kushtet e qëndrimit në këtë burg ishin mjaft të vështira dhe ai ishte për së tepërmi i ngarkuar me të burgosur. Kështu, në vitin 1950, në burgun e Tiranës kishte 902 të burgosur politikë dhe 873 të burgosur ordinerë, ndonëse kapaciteti i tij ishte për 287 të burgosur politikë dhe 191 të burgosur ordinerë.<sup>22</sup> Deri në vitin 1967 Burgu i Tiranës ishte dispenseri për të sëmurët turbekular të dënuar dhe të paraburgosur. Pas vitit 1967 e deri më 1998 ky burg mori karakterin e një burgu transit, në të cilin qëndronin, përveç të dënuarve, edhe të arrestuarit, ku prej këtej shpërndaheshin në burgjet e tjera të vendit. Gjatë sistemit komunist në këtë burg është kryer hetuesia ndaj disa personaliteteve të larta politike të regjimit komunist si: Beqir Balluku, Kadri Hazbiu, Abdyl Këllezi, Petrit Dume etj.<sup>23</sup> Ndërsa gjatë vitit 1991-1992 në këtë burg si të burgosur ishin edhe disa nga bashkëpunëtorët e ngushtë të E.Hoxhës, në krye me të venë e Enverit, Nexhmije Hoxha. Burgu 313 i Tiranës aktualisht shërben vetëm për mbajtjen e personave të paraburgosur.

**Burgu i Burrelit.** Ky burg ka filluar të ndërtohet në fillim të vitit 1938 nga Mbretëria Shqiptare, por mbeti i papërfunduar për shkak të pushtimit italian më 7 prill 1939. Ky burg gjendet në lindje të qytetit të Burrelit dhe funksionon ende. Gjatë kohës së pushtimit fashist ky burg është përdorur për stalla kuajsh, ndërsa gjatë kohës së sundimit komunist ishte një ndër burgjet famëkeqe për personat e dënuar, në rend të parë për kundërshtarët e regjimit. Ky burg ka formën e një paralelepipedit dhe rrethohet me një mur betoni të lartë që bënë të pamundur shikimin nga jashtë-brenda. Po ashtu ai mbulohet me një tarracë të trashë betoni rreth 40 cm trashësi. Pas vendosjes së pushtetit

---

<sup>21</sup> Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 152, Dosja 954, viti 1943.

<sup>22</sup> Sipas: Burgu i Tiranës 1943-2000 (material që ndodhet në Burgun 313 të Tiranës).

<sup>23</sup> A.Musta, op.cit., fq.11.

totalitar në Shqipëri, aty kah fillimi i vitit 1946, në këtë burg janë sjellë një numër i madh i të dënuarve prej burgjeve të tjera, të cilët ishin kryesisht të dënuar politikë dhe kundërshtarë të regjimit. Nga të dhënat e literaturës mbi burgjet mësojmë se gjatë periudhës 1946-1949 të dënuarit kanë pasur në dispozicion vetëm 400 gram bukë në ditë dhe asgjë tjetër dhe se nga kushtet tejet të rënda të qëndrimit gjetën vdekjen rreth 300 të burgosur.<sup>24</sup> Përveç kushteve të vështira të mbajtjes së dënimit dhe pozitës së vështirë të personave të dënuar, duhet shtuar se në këtë burg kishte një ngarkesë tejet të madhe me persona të dënuar, që e kalonte kapacitetin e tij. Në periudhën 1992-1997 ky burg nuk ka funksionuar, por ishte burg-muze. Më 1997 Burgu i Burrelit është rihapur dhe funksionon edhe tash në mungesë të kapaciteteve të nevojshme të burgjeve për shkak të shkatërrimit të tyre që pësuan gjatë ngjarjeve të marsit të këtij viti.

**Kampi i Maliqit.** Ky kamp është hapur në vitin 1947 dhe ka funksionuar deri në vitin 1952. Ai konsiderohet një ndër kampet më të mëdha gjatë kohës së sundimit komunist, në të cilin personat e dënuar kanë bërë punë tejet të rënda në tharjen e kënetës së Maliqit. Kampi i Maliqit ndahej në tri kampe: në atë të Vloçishtit, të Orman Pojanit dhe të Nishavecit. Në këtë kamp kanë punuar rreth 2000 të burgosur gjatë periudhës së ekzistimit të tij.<sup>25</sup> Kushtet e qëndrimit dhe të punës së personave të dënuar në këtë kamp ishin mjaft të vështira, me ushqim të dobët, ku nuk mungonin edhe torturat më çnjerëzore ndaj tyre. Të dënuarit në këtë kamp kishin si ushqim një supë patate dhe vetëm 600 gram bukë misri në ditë.<sup>26</sup> Numri i të vdekurve në këtë kamp, për shkak të trajtimit mizor dhe kushteve të vështira të punës, ishte në 62 persona.<sup>27</sup>

**Kampi i Spaçit.** Ky kamp ka funksionuar gjatë periudhës 1968-1990, ku me mijëra të dënuar kanë punuar punë mjaft të rënda dhe në kushte tejet të vështira. Në këtë kamp janë dërguar kryesisht të dënuarit politikë, të cilët ishin të përfshirë në procesin e punës për

---

<sup>24</sup> Ibid., fq.11. Motoja e këtij burgu ishte "Këtu i thonë Burrel, që hyn dhe s' del".

<sup>25</sup> Ibid., fq.13.

<sup>26</sup> Ibid.

<sup>27</sup> Ibid.

nxjerrjen e mineraleve të bakrit dhe piritit në galerat e Spaçit. Ky kamp ishte i ndërtuar në një gropë të rrethuar me male të larta, ndërsa të dënuarit punonin në tri ndërresa me mjete primitive të punës dhe pa ndonjë sigurim të mirëfilltë teknik. Temperaturat në dimër ishin mjaft të ulëta dhe arrinin deri në -15 °C. Përveç punës së rëndë që bëhej në këtë kamp, ndaj të dënuarve përdorej mjaft shpesh edhe dhuna dhe tortura. Si përgjigje ndaj kushteve të rënda të punës si dhe të dhunës së përdorur dhe torturave ndaj të dënuarve, në këtë kamp kanë ndodhur disa raste të përpjekjeve për arratisje dhe revolta të të dënuarve, të cilat zakonisht kanë përfunduar me vrasjen ose me ridënimin e tyre me dënime të gjata kohore. Po ashtu disa prej të dënuarve kanë pësuar edhe trauma psikike dhe në këtë mënyrë kanë bërë vetëvrasje ose janë hedhur në telat e rrethimit për t'u vrarë nga rojet e rrethimit.<sup>28</sup> Në këtë kamp është shënuar revolta më e madhe në historinë e burgjeve dhe kampeve të punës të regjimit komunist kundër dhunës dhe terrorit që ushtrohej vazhdimisht ndaj të dënuarve. Kjo revoltë ka ndodhur në muajin maj të vitit 1973.<sup>29</sup> Kështu, si pasojë e dhunës së ushtruar dhe të trajtimit mizor ndaj të dënuarve, në maj të vitit 1973, të dënuarit u hodhën në revoltë të përgjithshme, duke ngritur flamurin kombëtar pa yllin e komunizmit. Pra, kampi bie në duart e të burgosurve. Por, mjaft shpejt forca të shumta policore, pas një përleshje disaditëshe me të dënuarit, duke qëlluar me zjarr në hapësirën e kampit dhe duke rrahur mizorisht të dënuarit e rraskapitur, arrijnë që t'i ri-arrestojnë pothuajse të gjithë të dënuarit. Në këtë mënyrë 4 ish të dënuar u pushkatuan pas një gjyqi të inskenuar në komandën e kampit, kurse 130 të tjerë u ri-dënuan me dënime të gjata kohore.<sup>30</sup> Pas kësaj revolte, dhuna dhe terrori u shtuan edhe më tej jo vetën në kampin e Spaçit, por edhe në burgjet dhe kampet e tjera të Shqipërisë komuniste.<sup>31</sup> Po ashtu u keqësua

---

<sup>28</sup> A.Musta, op.cit., fq.16.

<sup>29</sup> Gjerësisht shih: Agim Musta, Spaçi, varri antikomunist ku filloi varrosja e komunizmit, Gazeta "Republika", datë 21.05.2000, Tiranë.

<sup>30</sup> Shih: A.Musta, *Mandelët e Shqipërisë*, fq.16; Josif Zegalli, *Rrëfime nga burgju i diktaturës komuniste*, Tiranë, 1999, fq.20 etj.

<sup>31</sup> Gjerësisht për ngjarjet rrëqethëse në këtë kamp shih: F.Lubonja, *Ridënimi*, Tiranë, 1996. Autori i këtij romani dokumentar, ish i dënuar politik, është një

dukshëm edhe pozita e personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit me burgim. Gjatë qëndrimit në këtë kamp kanë vdekur disa dhjetëra të dënuar dhe shumë prej tyre morën sëmundje të pashërueshme. Ky kamp është mbyllur në vitin 1990.

**Kampi i Qafëbarit.** Ky kamp është hapur 21 km në lindje të Fushë-Arrzit dhe ka funksionuar në periudhën 1982-1990. Në këtë kamp kanë punuar rreth 400-500 të dënuar politikë me tri ndërrime për nxjerrjen e mineraleve të bakrit dhe piritit.<sup>32</sup> Kushtet e jetës dhe të punës së personave të dënuar në këtë kamp ishin mjaft të rënda, ku të dënuarit të cilët nuk e plotësonin normën e caktuar u nënshtroheshin torturave më shtazarake. Madje edhe prej të dënuarve të sëmurë kërkohesh realizimi i normës. Si përgjigje ndaj dhunës dhe torturës së ushtruar nga personali i kampit, në vitin 1984 të dënuarit u hodhën në revoltë, ku si pasojë e saj u ri-arrestuan 40 veta, prej të cilëve 3 u dënuan me vdekje e 14 sish u ri-dënuan me dënime të gjata kohore.<sup>33</sup> Pas kësaj revolte, u shtuan me të madhe rrahjet dhe torturat ndaj të dënuarve si dhe u keqësua edhe më tej pozita e tyre në këtë kamp.

**Kampi për hapjen e kanalit Peqin-Kavajë.** Ky kamp ka funksionuar gjatë periudhës 1952-1955, ku rreth 2000 të dënuar kanë punuar në hapjen e kanalit 50 km të gjatë në afërsi të qytetit të Peqinit e deri në qytetin e Kavajës. Edhe në këtë kamp kanë punuar ish të dënuarit politikë, ku kushtet e punës ishin mjaft të rënda si dhe mungonte edhe uji i mjaftueshëm për pije. Gjatë punës në hapjen e kanalit kanë gjetur vdekjen rreth 23 veta.<sup>34</sup> Po ashtu janë përdorur edhe torturat ndaj të dënuarve.

**Kampi i Ballshit.** Ky kamp është ndërtuar në lindje të qytetit të Ballshit dhe ka funksionuar gjatë periudhës 1971-1984. Në këtë kamp kanë punuar rreth 1000 të dënuar për ndërtimin e uzinës së naftës dhe ndërtim apartamentesh në qytetin e Ballshit.<sup>35</sup> Edhe në këtë kamp gjetën vdekjen disa dhjetëra të dënuar.

---

ndër protagonistët e ngjarjeve që kanë ndodhur në këtë kamp, i cili na pasqyron në mënyrë të shkëlqyer momentet dhe skenat tronditëse të tij.

<sup>32</sup> A.Musta, op.cit., fq.17.

<sup>33</sup> Ibid.

<sup>34</sup> Ibid., fq.19.

<sup>35</sup> Ibid., fq.22.

**Kampi i Torovicës.** Ky kamp është ngritur në verilindje të Lezhës, rrëzë malit Kolaj e përbri kënetës së Kakarriqit dhe ka funksionuar në periudhën 1968-1991. Në këtë kamp kanë punuar personat e dënuar të rinj të moshës 14-20 vjeç, ku numri i tyre ishte rreth 400 veta.<sup>36</sup> Personat e dënuar punonin në bujqësi, duke hapur kanale dhe toka të reja pune. Ky kamp shërbente gjatë sistemit komunist si “model riedukimi” për të dënuarit politikë. Në të vërtetë, edhe në këtë kamp kushtet e jetës dhe të punës së të dënuarve ishin mjaft të rënda.

Edhe në burgjet dhe kampet e tjera të punës të kësaj periudhe të gjatë kohore kushtet e jetës dhe të punës së personave të dënuar ishin mjaft të vështira. Këto burgje dhe kampe të punës pothuaj se u shndërruan në një industri të vërtetë, me të cilën ishin të lidhura të gjitha ndërtimet e vendit dhe të cilat mbajnë vulën dhe djersën e të dënuarve. Veçmas ishte e rëndë pozita e të dënuarve politikë, të cilët ndaheshin nga të dënuarit ordinerë dhe të cilët mbanin mbi vete nofkën “armiqtë e popullit”, me pasoja të rënda për ta dhe anëtarët e familjeve të tyre.

Gjatë periudhës së shtetit totalitar janë të njohura edhe disa burgje dhe kampe të punës në të cilat kanë mbajtur dënimin një numër i madh i femrave të dënuara. Kështu, qysh me vendosjen e shtetit totalitar, në Burgun e vjetër të Tiranës dhe në burgjet e tjera të Shqipërisë krijohen anekse të posaçme për mbajtjen e dënimit nga femrat e dënuara. Si burgje dhe kampe të punës më të njohura për të dënuarat femra gjatë kësaj periudhe kohore ishin: *Kampi i Valiasit të Tiranës*, *Burgu i Artizanatit të Tiranës*, *Kampi i Kuçovës*, *Kampi i Kosovës së Lushnjës*, *Kampi në Sharrë të Tiranës etj.*<sup>37</sup> Në këto burgje dhe kampe të punës kushtet e mbajtjes së dënimit ishin mjaft të vështira dhe puna e të dënuarve femra ishte mjaft e rëndë. Ndaj tyre mjaft shpesh është përdorur edhe tortura. Në mesin e femrave të dënuara kishte mjaft intelektuale të shquara shqiptare, të cilat qëndruan në burgjet dhe kampet e punës me vite të tëra. Këtu vlen të përmendet intelektualja dhe politikanja e shquar shqiptare, Musine Kokolari, e cila mbajti 37 vjet burgim dhe internim. Ajo në vitin 1943 formon në ilegalitetet

---

<sup>36</sup> Ibid., fq.23; J.Zegalli, op.cit., fq.17.

<sup>37</sup> Gjerësisht shih: A.Musta, op.cit., fq.13-14; J.Zegalli, op.cit., fq.21-22. etj.

Partinë Social-Demokrate Shqiptare, ndërsa në vitin 1945 formon grupin politik “Bashkimi Demokratik”. Në vitin 1946 dënohet nga një gjykatë ushtarake me 20 vjet burgim. Para gjyqit ajo do të deklarojë me guxim: “Unë s’jam komuniste, por kjo s’bënë faj për të më dënuar. Unë jam nxënëse e rilindësve të kombit tim. Duke më dënuar mua, ju dënoni Rilindjen Kombëtare Shqiptare”.<sup>38</sup> Në burg ajo u kthye në simbol qëndrese për të gjitha gratë e burgosura shqiptare. Pas kryerjes së dënimit, ajo internohet përjetësisht në Mirditë ku qëndroi e pamposhtur deri në vdekje.

Në burgjet dhe kampet e punës të Shqipërisë komuniste, përveç të dënuarve shqiptarë, kanë mbajtur dënimin edhe disa qindra qytetarë të tjerë me shtetësi të huaj. Edhe këta të dënuar u janë nënshtruar kushteve mjaft të vështira të mbajtjes së dënimit dhe punës mjaft të rëndë në burgjet dhe kampet e punës. Po ashtu edhe ndaj tyre janë përdorur dhuna dhe torturat e ndryshme mizore.<sup>39</sup>

## ***2. Pozita e personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit me burgim në Shqipëri gjatë periudhës së diktaturës komuniste***

Nga trajtimi i deritashëm, mund të konstatohet me të drejtë se numri i burgjeve dhe kampeve të punës si dhe numri i personave të dënuar gjatë kësaj periudhe kohore ishte mjaft i madh. Kjo bëhej për qëllime të caktuara. Me të drejtë autorët H.Sulo dhe P.Kaso theksojnë se zakonisht plani i arrestimeve caktohej nga lart dhe ishte direktivë që duhej përmbushur për dy qëllime: të sigurohej kontingjenti sa më i madh i të dënuarve për punët pa pagesë dhe me qëllim që të frikësohej pjesa tjetër e popullsisë në mënyrë që ajo të bëhej e dëgjueshme.<sup>40</sup> Gjatë kësaj periudhe, numri i të dënuarve politikë ishte mjaft i

---

<sup>38</sup> Shih: Fondacioni “Musine Kokolari” 1917-1983, Tiranë.

<sup>39</sup> Në këtë drejtim dëftojnë ditarët dhe dëshmitë e të dënuarve të huaj si: Giacomo Gardini, Dhetë vjet burg në Shqipëri (1945-1955), Romë, 1992; Nazmi. B.Dyzi, 20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës, Berat, 1995 etj.

<sup>40</sup> H.Sulo-P.Kaso, *Diktatura...*, Tiranë, 1995, fq.4. Në këtë drejtim, K.SH. ish-funksionar i Degës së Brendshme të Lushnjës, i cili vuante dënimin katërvjeçar në Kampin e Batrës për gjoja “mungesë vigjilence”, “shmangie nga detyra” pat konfirmuar: Na vinin herë pas here të dërguar nga Ministria e



madh. Madje mund të thuhet se edhe një pjesë e të dënuarve ordinerë ishin të dënuar për motive politike dhe se masa e dënimit nuk i është përgjigjur përherë peshës së krimit, me përjashtim të disa krimeve si ai i vrasjes, i grabitjes ose i marrëdhënieve seksuale me dhunë. Kështu, p.sh., për vepra të lehta penale jepeshin dënime tejet të rënda, vetëm pse ata kishin kryer më parë ndonjë dënim të rëndë politik ose regjimi komunist ua kishte pushkatuar ndonjë anëtar të afërm të familjes së tyre.<sup>41</sup>

Gjatë periudhës së sundimit komunist, burgjet dhe kampet e punës kishin një organizim të caktuar dhe personelin e tyre. Në vitet e para pas çlirimit, në burgje erdhën kryesisht njerëzit nga lufta të cilët shquheshin për besnikëri të lartë ndaj Partisë Komuniste, por të cilët nuk kishin ndonjë përgatitje të duhur për punë në burgje. Shumë prej tyre ishin të pashkolluar ose me vetëm disa klasë mësimore. Ndërsa, pas viti 1970 në burgje emërohen kryesisht oficerë të cilët kishin mbaruar shkollën ushtarake ose të policisë. Nga burimet arkivore mbi burgjet mësojmë se në vitin 1956 rrethimin e jashtëm të burgjeve dhe të kampeve e bënë ushtarët e stërvitur. Kësisoj, në një analizë vjetore të Drejtorisë së Kampeve dhe Burgjeve të vitit 1956, ndër të tjera, thuhet: "...Me ushtarët e ardhur në burgje dhe kampe është e domosdoshme puna stërvitore, por mbi të gjitha sqarimi i tyre për qëndrimin që duhet të mbajë kundër elementit armik. Të njohin cilët janë këta armiq, në mënyrë që ushtarët t'i urrejnë plotësisht. Të sqarohet qëndrimi i tyre edhe ndaj familjeve të burgosurve..."<sup>42</sup>

Struktura organike apo organizative e burgjeve kryesisht ishte: komandant, komisar, evidencier (oficer), referent prapavije (oficer),

---

Brendshme dhe na pyesnin se ku ishim me planin e arrestimeve. Unë u përgjigjesha: Si mund t'i arresojmë njerëzit kot, kur s'kemi pasur asnjë ngjarje në Rreth?! - S'është kjo, jo, por ju nuk punoni mirë, s'jeni vigjilentë! - na hiqnin vërejtjen ata të Ministrisë". (Ibid.).

<sup>41</sup> Në këtë drejtim, ish-prokurorja e Tiranës, Hava Bekteshi, pat deklaruar: "...Masa e dënimit për secilin të pandehur që do të kalonte në procesin penal gjyqësor na vinte e rekomanduar nga Ministria e Brendshme". (Cit. sipas H.Sulo-P.Kaso, op.cit., fq.9).

<sup>42</sup> Arkivi i Ministrisë së Rendit Publik, Fondi Dega e Kampeve dhe e Burgjeve, Dosja 47, viti 1956.

komandant për shërbimet në burg dhe stërvitjen, një mjek dhe një infermier, si dhe një togë ushtarësh për rrethimin e jashtëm dhe një togë policësh për rrethimin e brendshëm.<sup>43</sup> Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë bërë edhe disa ndryshime të vogla në strukturën organizative dhe numrin e personelit, gjë që diktohej nga nevojat e kohës.

Gjatë periudhës së sundimit komunist pozita e personave të dënuar në burgje dhe kampe të punës ishte e vështirë. Këtë e vërtetojnë mjaft mirë burimet arkivore, të dhënat e tjera dhe dëshmitë e ish-personave të dënuar, të cilat i referohen vendosjes, ushqimit dhe trajtimit shëndetësor të të dënuarve, punës së rëndë të tyre, rasteve të sëmundjeve dhe të vdekjeve në burgje dhe kampe të punës, kufizimit të të drejtave të personave të dënuar, përdorimit të shpeshtë të dhunës dhe të torturës ndaj tyre, ri-dënimit të tyre etj.

Nga të dhënat dhe dëshmitë e ish të dënuarve të kësaj periudhe kohore mësojmë se deri në vitin 1950 në burgje si ushqim i vetëm ishte buka e misrit, e pashoqëruar me gjellë. Vetëm në mars të vitit 1950, qeveria kishte vendosur që t'u jepte të dënuarve përveç bukës edhe supë. Në vendimin e qeverisë për përdorimin e supës në burgje, ndër të tjera, lexojmë edhe këtë: "...Të sqarohen të burgosurit për rëndësinë politike të problemit, se pushteti popullor mendon për ta, me gjithë veprimtarinë e tyre armiqësore".<sup>44</sup> Në burgjet dhe kampet e kësaj periudhe, siç rrëfejnë ish të dënuarit, uria ishte mjaft e shpeshtë. Kësisoj, një ish i burgosur në Burgun e Burrelit, ndër të tjera, rrëfen: "Na prunë një të ri çam shumë të sëmurë në dhomën nr.7. Mbas dy ditësh, ai vdiq, por na, nuk lajmëruam gardianët për vdekjen e tij, se deshëm të përfitonim racionin e bukës. Për t'i mashtruar gardianët i vendosëm të vdekurit një cigare në gojë. E mbajtëm ashtu katër ditë, gjersa filloi të dekompozohet. E bëmë atë të pabërë, për të përfituar nga 100 gramë bukë më tepër se racioni. Deri aty na çoi uria."<sup>45</sup> Për shkak të kushteve të rënda të qëndrimit në burgje dhe kampe të

---

<sup>43</sup> Sipas F.Sufaj, op.cit., fq.114.

<sup>44</sup> Arkivi i Ministrisë së Rendit Publik, Fondi Dega e Kampeve dhe e Burgjeve, Dosja 10, viti 1950.

<sup>45</sup> Sipas A.Mustës, Dosjet e gjalla, "Arbëria", Tiranë, 1995, fq.164.

punës, të mungesës së mjaftueshme të ushqimit, të gjendjes së rëndë higjiene-sanitare etj., janë paraqitur edhe raste të sëmundjeve të ndryshme dhe të vdekjeve të të dënuarve. Kështu, p.sh., në një raport të degës së kampeve dhe të burgjeve të Burgut të Burrelit të vitit 1950 mësojmë se shumica e të dënuarve ishin me skorbut, malarie, zgjebe, dizenteri, reumatizëm etj.<sup>46</sup>

Ndaj personave të dënuar në burgje dhe kampe të punës është përdorur edhe dhuna fizike. Ndëshkimi fizik ndaj personave të dënuar është aplikuar veçmas në kampet e punës dhe kishte për qëllim realizimin e normës ditore dhe të planit shtetëror. Duke u nisur nga fakti se puna e të dënuarve në disa kampe të punës ishte tejet e rëndë, sidomos në galeritë për nxjerrjen e xeheve (të Spaçit, Bulqizës, Batrës etj.) dhe në bonifikimin apo tharjen e kënetave (të Maliqit, Tërbufit etj.), janë shënuar edhe raste kur disa nga të dënuarit u gjymtuan me vetëdije të plotë vetëm e vetëm për t'i shpëtuar punës së rëndë rraskapitëse dhe ndëshkimit të rëndë fizik. Disa prej të dënuarve, për shkak të refuzimit të punës, u ndëshkuan me izolim, e disa të tjerë gjetën edhe vdekjen për shkak të punës së rëndë dhe mungesës së sigurimit në punë.<sup>47</sup>

Nga rrëfimet dhe dëshmitë e ish-personave të dënuar si dhe të dhënat e tjera të kësaj periudhe kohore mësojmë se ndaj të dënuarve në burgjet dhe kampet e punës është përdorur edhe tortura.<sup>48</sup> Janë të

---

<sup>46</sup> Arkivi i Ministrisë së Rendit Publik, Fondi Dega e Kampeve dhe e Burgjeve, Dosja 10, viti 1950.

<sup>47</sup> Kështu, p.sh., në zonën "D" të minierës së Bulqizës, në janar të vitit 1979, vdiqën për shkak të helmimit nga gazi 9 të dënuar ordinerë. ( Cit. sipas H.Sulo-P.Kaso, op.cit., fq.15).

<sup>48</sup> Sipas "Konventës kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese", miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 39/46, datë 10 dhjetor 1984, hyrë në fuqi më 26 qershor 1987, me termin "torturë" kuptojmë: "...çdo veprim, me anën e të cilit një personi i janë shkaktuar me dashje dhimbje ose vuajtje të rënda, fizike ose mendore, me synim për të marrë prej tij ose prej një tjetri informata ose pohime, për ta ndëshkuar për një veprim që ai ka kryer ose dyshohet që e ka kryer, për ta frikësuar atë ose për të bërë presion mbi një person tjetër, ose për çdo motiv tjetër të bazuar në një formë të çfardollojshme, kur një dhimbje e tillë ose vuajtje të tilla janë shkaktuar nga një person zyrtar ose nga çdo person tjetër

njohura disa metoda të torturës, të cilat mund të ndahen në fizike dhe psikologjike, me pasoja mjaft të rënda për individët. Si tortura më të shpeshta fizike përmenden: rrahja sistematike, tortura seksuale, tortura elektrike, tortura e mbytjes, djegia, gjendja e ankthit, tortura farmakologjike, gjymtimet dhe tortura dentalë; ndërsa si tortura më të shpeshta psikologjike konsiderohen: privimi ose rraskapitja, kërcënimet për t'u torturuar, gjymtuar, vrarë si dhe duke kërcënuar pjesëtarët e familjes dhe miqtë, prania e njerëzve të tjerë gjatë torturimit si dhe poshtërimi dhe tortura seksuale.<sup>49</sup> Disa nga këto lloje të torturave janë aplikuar edhe ndaj personave të akuzuar gjatë hetuesisë si dhe ndaj personave të dënuar në burgjet dhe kampet e punës gjatë kohës së sundimit komunist. Kësisoj, sipas demonstrimit vizual dhe dokumentar të "Pavionit të Gjenocidit komunist" pranë Muzeumit Kombëtar në Tiranë, si mjete dhe forma të torturave që përdorehin në burgjet dhe kampet e punës gjatë sistemit komunist në Shqipëri ishin: 1. jeleku i torturës (torturë e tmerrshme),<sup>50</sup> 2. dëmtimi i organeve gjenitale, 3. kamxhiku dhe druri, 4. lënia pa bukë, pa ujë, pa gjumë dhe në këmbë për ditë të tëra, 5. përdorimi i korrentit elektrik deri në humbjen e ndjenjave, 6. varja në qafë e zinxhirëve me pesha të rënda, 7. varja prej krahësh të lidhura mbrapa në dritare ose në dru, në lartësi që të prekin tokën gishtërinjtë e këmbëve, 8. futja kripë në gojë me mbushje të plotë të gojës, 9. dërgimi gjoja për pushkatim, zbrazje armësh dhe ngjitja në trekëmbëshin e varjes, 10. futja me kokë poshtë në fuçi me ujë, 11. djegia e mishit me cigare, 12. hedhja e alkoolit në duar apo në flokë dhe ndezja e flakës, 13. thyerja e kockave dhe shkulja e mishit me darë, 14. dhënia gjellë të kripur dhe më pas

---

që vepron me titull zyrtar ose me nxitjen e tij ose me miratimin e tij të shprehur ose të heshtur". (Shih nenin 1 të kësaj Konvente, botuar në: Përmbledhje aktesh ndërkombëtare, Tiranë, 1994, fq.183).

<sup>49</sup> Gjerësisht për metodat e torturës dhe pasojat e saj shih: Lone Jacobsen-Peter Vesti, *Ata që i mbijetojnë torturës (një grup i ri pacientësh)*, Këshilli Ndërkombëtar për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës, Kopenhagë-Danimarkë, Ribotim, 1995, fq.16-26.

<sup>50</sup> Kjo formë e torturës zbatohet përmes shtrëngimit në masë të madhe të trupit të njeriut, pra të shpinës dhe belit, me anën e një mjeti në formë të jelekut duke i shkaktuar dhimbje të mëdha të dënuarit.

lënia pa ujë, 15. futja në ujë dhe lënia të lagur në dimër, 16. pakësimi gradual i ushqimit për të shkaktuar vdekje pas një kohe të caktuar,<sup>51</sup> 17. përdorimi i lëndëve për ngacmimin apo dëmtimin e sistemit nervor, 18. helmata të posaçme në kokë, që i burgosuri të mos vetëvritet, 19. lidhja në pranga duar e këmbë për një kohë të pacaktuar, 20. përdorimi i zgjonjve me bletë ndaj të burgosurve të zhveshur etj.

Edhe dëshmitë dhe përjetimet e personave të dënuar si dhe deklaratat e vetë personave të cilët kishin qenë të urdhëruar për ta përdorur torturën ndaj personave të akuzuar dhe të dënuar dëftojnë për lloje të ndryshme të torturave gjatë kësaj periudhe kohore, të cilat janë përdorur ndaj personave të dënuar.<sup>52</sup> Tortura shkakton pasoja të mëvonshme fizike dhe psikike dhe ajo nuk është e tmerrshme vetëm në momentin e kryerjes, por shumë më të tmerrshme janë pasojat e mëvonshme të saj. Qëllimi i saj nuk ka të bëjë vetëm me nxjerrjen e ndonjë informacioni apo të ndonjë rrëfimi, por ai shtrihet edhe në shkatërrimin e identitetit dhe personalitetit të njeriut.<sup>53</sup>

---

<sup>51</sup> Kështu, p.sh., Kostaq (Koço) Kota, ish-Kryeministër dhe Ministër i Brendshëm në qeverinë e Mbretërisë Shqiptare, vdes në Burgun e Burrelit me anë të pakësimit gradual të ushqimit. (Shih: Klement Shamari, Drama e Ministrave të Brendshëm të Shqipërisë, Tiranë, 1999, fq.46).

<sup>52</sup> Ndër të tjera, përmenden edhe këto lloje të torturave: rrahja me dru derisa të bëhen plagë dhe të bjerë mishi, kruarja e plagëve të qelbura me dru, shpuarja e mishit me tel të djegur, elektrik në vesh, futja e kripës në mish të djegur, lagia me ujë të ftohtë, lënia pa bukë deri në vdekje, lënia pa bukë për disa kohë, lënia zhveshur në të ftohtë, jeleku, shtrëngimi i gishtërinjve me pinca, të pegerët (fektele) në gojë, varje me kokë poshtë, lidhje për liri (për pemë), përgatitje varri, pushkë në gojë, tentim për çnderim të vajzës etj. (Shih: Pjetër Pepa, Dosja e diktaturës, Tiranë, 1995, fq.241). Lidhur me vuajtjet dhe torturat e të dënuarve gjatë sistemit komunist shih edhe: J.Zegalli, Rrëfime nga bugu i diktaturës komuniste; A.Musta, Dosjet e gjalla, Tiranë, 1995; Nazmi B.Dyzi, 20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës; Engjëll Kokoshi, Kalvar vuajtjesh dhe mjerimesh, Revista shqiptare për të drejtat e njeriut, volumi 1, nr.1, Tiranë, 1995, fq.46-48 etj.

<sup>53</sup> Meqë shumë persona të dënuar u janë nënshtruar torturës gjatë kohës së regjimit komunist, ata kanë nevojë të rehabilitohen. Për këtë qëllim në Tiranë funksionon Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës,

Gjatë periudhës së sundimit komunist janë bërë edhe disa amnisti dhe falje të personave të dënuar. Zakonisht ato jepeshin dhe propagandoheshin si shenjë e “zemërgjerësisë” së Partisë dhe bëheshin në prag të festave apo edhe të përvjetorëve dhe ngjarjeve të ndryshme. Në të shumtën e rasteve, me këto amnisti dhe falje përfitonin të dënuarit ordinerë, ndërsa ata politikë-më rrallë, gjë që flet më së mirë për qëndrimin e shtetit komunist që kishte ndaj kategorisë së të dënuarve politikë. Si arsye më të shpeshta të dhënies së amnistive dhe të faljeve ishte mbipopullimi i burgjeve.

### ***Përfundimi***

Nga analiza dhe trajtimi i burgjeve dhe kampeve të punës, të organizimit të tyre dhe të pozitës së personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit me burgim gjatë sundimit komunist në Shqipëri, mund të pohohet me plot të drejtë se qëllimi i ekzekutimit të këtij dënimi nuk kishte të bënte me riedukimin dhe risocializimin e personave të dënuar, por për më tepër ky dënim ka përmbajtur mjaft elemente retributive, pra të hakmarrjes dhe shpagimit, si dhe ka ndikuar edhe në frikësimin e pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë. Veçmas ishte e rëndë pozita e të dënuarve politikë, të cilët, e mbanin edhe nofkën “armiqtë e popullit”, me pasoja të rënda për të ardhmen e tyre dhe të familjeve të tyre. Për këtë dëftojnë mjaft mirë të dhënat për numrin e madh të burgjeve dhe kampeve të punës, për numrin e madh të personave të dënuar, kushtet mjaft të rënda të punës së tyre, trajtimin johuman të tyre, përdorimin mjaft të shpeshtë të dhunës dhe të torturës, organizimin e gjyqeve në këto burgje dhe kampe të punës, ri-dënimin e personave të dënuar etj. Ndërkaq, si përgjigje ndaj kësaj dhune dhe gjendjes së rëndë në burgjet dhe kampet e punës të kësaj periudhe pati disa herë tentim arratisje dhe revolta në radhët e të dënuarve, të cilat, mjerisht, përfunduan me ri-dënimin e tyre dhe me keqësimin e mëtejshëm të pozitës së të dënuarve.

---

e cila ka filluar veprimtarinë e saj në gusht të vitit 1993 dhe ka qëllim të dyfishtë: rehabilitimin mjekësor (fizik dhe psikologjik) dhe të ndihmojë në parandalimin e torturës.

## **Bibliografia**

- Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 152, viti 1943.
- Arkivi i Ministrisë së Rendit Publik, Fondi Dega e Kampeve dhe e Burgjeve, Dosja 10, viti 1950.
- Arkivi i Ministrisë së Rendit Publik, Fondi Dega e Kampeve dhe e Burgjeve, Dosja 47, viti 1956.
- Burgu i Tiranës 1943-2000, (material i pabotuar).
- Dekretligja mbi ekzekutimin e dënimeve*, Gazeta zyrtare nr.5, Tiranë, 1947.
- Dekreti nr.1317 "Mbi faljen e dënimeve", Gazeta zyrtare nr.21, Tiranë, 1951.
- Dekreti nr.3584 "Për ekzekutimin e vendimeve penale"*, Tiranë, 1962.
- Dyzi, B.N., *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës, "Uegen"*, 1995.
- Elezi, I., *Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri, "Albin"*, 1998.
- Fondacioni "Musine Kokolari" 1917-1983*, Tiranë.
- Gardini, Giacomo, *Dhet vjet burg në Shqipni (1945-1955), "La Civilita Cattolica, Romë*, 1992.
- Jacobsen, L., Vesti, P., *Ata që i mbijetojnë torturës (një grup i ri pacientësh)*, Këshilli Ndërkombëtar për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës, Kopenhagë, 1995.
- Kodi penali Republikës Popullore të Shqipërisë i vitit 1952*, Tiranë, 1959.
- Kodi i procedurës penale i Republikës Popullore të Shqipërisë*, Tiranë, 1953.
- Kodi penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*, Tiranë, 1977.
- Konventa kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese*, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme nr.39/46, 10 dhjetor 1984.
- Ligji nr.6299 "Për faljen"*, Tiranë, 1981.
- Ligja penale otomane, "Mbrothësija"*, 1924, Tiranë.
- Lubonja, F., *Ridënimi*, Tiranë, "Përpjekja", 1996.

- Musta, A., *Mandelët e Shqipërisë, "Naim Frashëri"*, Tiranë, 1993.
- Musta, A., *Dosjet e gjalla, "Arbëria"*, Tiranë, 1995.
- Musta, A., *Burgjet e shtetit burg (Prisons of the Prison State), "Toena"*, Tiranë, 2000.
- Rregullore mbi sigurimin dhe riedukimin e të dënuarve në Repartet e Riedukimit dhe Burgjet*, Ministria e Punëve të Brendshme, nr.01-78, Tiranë, 1986.
- Sufaj, F., *Historia e burgjeve të Shqipërisë gjatë shekullit XX, "Albini"*, Tiranë, 2000.
- Sulo, H. – Kaso, P., *Diktatura...*, "Alta", Tiranë, 1995.
- Shamari, K., *Drama e Ministrave të Brendshëm të Shqipërisë, "Vilson Arbëri"*, Tiranë, 1999.
- Zegalli, J., *Rrëfime nga burgu i diktaturës komuniste, "Koha"*, Tiranë, 1999.